



---

**VENDIM**

***Nr. 101 Datë 15. 12. 2009***

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR  
TË LIÇENSUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HIDROCENTRALET E RINJ ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW PËR  
PERIUDHËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Minsitrave Nr. 87 , date 16.01.2008 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.27 date 19.01.2007 “ Per miratimnin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncensioneve” , neneve 15; 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.24, datë 11.04.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën 1 janar- 31 dhjetor 2010,

**Vendosi :**

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2010 do të jetë 6.00 leke/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licensuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



---

**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

***VENDIMIN***  
***Nr. 101 Datë 15.12.2009***

**PËR**  
**PERCAKTIMIN E CMIMIT UNIK TE SHITJES SE ENERGJISE**  
**ELEKTRIKE PER TE LICENSUARIT PER PRODHIMIN E**  
**ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET E RINJ ME**  
**FUQI TE INSTALUAR DERI NE 15 MW PER PERIUDHEN 1 JANAR -**  
**31 DHJETOR 2010**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkëlqim Bozgo</b>	_____	_____

